



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.108 Datë 03/10/2023

“ PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “ b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr.459, datë 3.7.2019 “ Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirase ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, bazuar në kërkesat e qytetarëve, me propozim të Kryetarit të Këshillit, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 03.10.2023 me 21 vota pro, 6 kundër dhe 3 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë familjet:
 - **Znj.Defe Pitarka** në masën **15.000** lekë/muaj.
 - **Znj. Fllanza Elezi** në masën **6.000** leke/muaj.
 - **Z.Rovjen Çeliku** në masën **6.000** lekë/ muaj.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë deri në muajin Janar 2024.
3. Për familjet, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pageses do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorisë Ekonomike, referuar kontratës të qerasë noteriale.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtorja e Ekonomike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit.
5. Vendimi u shpall me datë 03.10.2023

